

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA, në përbërje nga trupi gjykues Vesel Ismaili – kryetar, gjyqtarët Naime Jashanica dhe Valbona Musliu-Selimaj, anëtarë të trupit gjykues, me procesmbajtësen Nurije Rexhëbeqaj, në çështjen penale kundër të akuzuarit për shkak të veprës penale Grabitje nga neni 329 par.1 të KPK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Krimeve të Rënda PP.nr.803/2015 dt.23.12.2016, në shqyrtimin gjyqësor, të hapur për publikun, të zhvilluar më datat: 27.02.2018, 20.03.2018 dhe me dt. 23.04.2018, në prezencën e Prokurorit të shtetit Besa Limani, të akuzuarit me mbrojtësin e tij av. , me autorizim dhe i dëmtuari – pas shqyrtimit gjyqësor publikë e vërbal, me datë 5. 6.2018, mori dhe publikisht shpalli këtë:

AKT GJYKIM

i biri i dhe e gjinisë i lindur me dt. në tani me vendbanim në rrugën “ ” hyrja Kati nr. në ka të kryer shkollën e mesme, me profesion punëtor në sektorin e i martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, me nr.ID , shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës.

Konform nenit 364, par. 1 nënpar. 1.3 të KPPRK-së,

LIROHET NGA AKUZA

S e p s e:

I pandehuri , duke përdorur forcën apo kanosjen serioze për të sulmuar jetën apo trupin e personit tjetër, duke pasur me vete armën-thikë, ka përvetësuar pasurinë e luajtshme të personit tjetër me qëllim që ti sjell vetes dobi pasurore të kundërligjshme në atë mënyre që me dt.30.12.2011 rreth orës 17:20 në rrugën “ ” në derisa i dëmtuari ka qenë duke ecur, i pandehuri i maskuar me një shalle në fytyrë papritmas, nga mbrapa e ka kapur për pallto të dëmtuarin ku me një dorë ia ka marrë telefonin e tipit “Iphone 4” me nr.të IMEI-t,01254500712908603 dhe sim kartelë me nr. ndërsa me dorën tjetër e ka kanosur me thikë dhe pasi ia ka grabitur telefonin , i pandehuri ka ikur në drejtim të Gërmisë.

Pasi që nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprën penale Grabitje, nga neni 329, par. 1, të KPRK-së. I dëmtuari për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontestin civil-juridikë.

Shpenzimet gjyqësore, bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

ARSYETIMI

Prokuroria Themelore në Prishtinë/Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ushtruar aktakuzën PP.nr.803/2015 dt.23.12.2016, kundër të pandehurit për shkak të veprës penale Grabitje, nga neni 329, par. 1 të KPRK-së.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor, të datës 20.03.2018, pas leximit të aktakuzës, i pandehuri

ka deklaruar se e ka kuptuar në tersi aktakuzën, veprën penale për të cilën akuzohet, por është deklaruar i pa fajshëm për veprën penale për të cilën është akuzuar.

Në fjalën hyrëse Prokurori i shtetit, ka deklaruar se në këtë çështje penale ka zhvilluar hetimet dhe siguruar provat të mjaftueshme, se i akuzuari e ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë, dhe kjo gjendje faktike do të vërtetohet nga deklaratat e të dëmtuarit-dëshmitarit _____ e cili i ka përshkruar veprimet inkriminuese të të pandehurit si dhe dëmi të cilit i është shkaktuar, ndërsa në fjalën përfundimtare, Prokurori i shtetit ka deklaruar, se mbetet në tersi pranë aktakuzës dhe i propozon gjykatës që i pandehuri të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit, pasi që gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se i pandehuri ka kryer veprën penale që i vihet në barrë, në kohë, vend dhe mënyrë siç është përshkruar në dispozitiv të aktakuzës, nga deklaratat e të dëmtuarit _____, i cili ka përshkruar se natën kritike personi i cili e ka grabitur ka qenë i maskuar me kapelë dhe shall, prandaj nuk ka mundur t'ia shoh fytyrën por ka theksuar se ka qenë i gjatë rreth _____ cm, gjë që përputhet me gjatësinë e të pandehurit _____ Dhe nga listingu i thirrjeve i hyrjeve-daljeve, vërtetohet se pas grabitjes së telefonit të të dëmtuarit _____ i vetmi person që ka përdorur këtë telefon ka qenë i pandehuri _____

I dëmtuari _____ në fjalën hyrëse ka deklaruar se e përkrah në tërësi fjalën hyrëse të Prokurorit të Shtetit dhe nuk kam çka të shtoj diçka tjetër.

Mbrojtësi i të akuzuarit _____ av. _____ në fjalën hyrëse ka deklaruar lidhur me aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda me të cilin e akuzon të mbrojturin tim, për shkak të veprës penale Grabitje nga neni 329 par.1 të KPK-së, e konsiderojmë se gjatë administrimit të provave nuk do të vërtetohet fajësia e të mbrojturit tim. Ndërsa, në fjalën përfundimtare, mbrojtësi ka theksuar se prokuroria me asnjë provë të vetme nuk ka mundur të vërtetoj tezën e aktakuzës, duke shtuar se gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor i dëmtuari-dëshmitari _____ ka dhënë deklaratë lidhur me ngjarjen kritike, por i njëjti asnjëherë nuk ka mundur që saktë të identifikoj se i mbrojturi im është personi i cili pretendohet se ka marrë pjesë në grabitjen e telefonit të tij, se kjo gjë është dëshmuar edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, kur dëshmitari ka deklaruar se lidhur me identifikimin e personit nuk ka mundur me ja pa fytyrën, dëshmitari në tërë deklaratën e tij të dhënë para trupit gjykues ka qenë kontradiktor, dhe asnjëherë nuk ka qenë i përqendruar apo i saktësuar se është me të vërtetë i njëjti person, dëshira e tij ishte ta mbyll këtë rast, prandaj në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar gjatë procedurës, mbrojtësi ka thënë se konsideron se nuk ka prova të mjaftueshme për të fajësuar ose dënuar dikë dhe në mungesë të provave, i ka propozuar gjykatës të nxjerr aktgjykim lirues në pajtim me nenin 364 par. 1 nëpar.1.3 të KPPK.

I akuzuari _____ në fjalën e tij përfundimtare, ka theksuar se e mbështet në tërësi fjalën e mbrojtësit të tij.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor, janë dëgjuar i dëmtuari-dëshmitari, janë administruar provat materiale, të propozuara nga prokuroria në aktakuzë.

Dëshmia e të dëmtuarit-dëshmitarit _____, i cili ka deklaruar se i kujtohet data 30.12.2011 rreth orës 17:20, grabitësin e përshkruan se ka qenë i hollë, zeshkan, i gjatë rrethe _____ cm, por më parë asnjëherë nuk e ka pa _____, nuk e di s.ja ka pa fytyrën se ka pas kapelë, shalle, nuk mundet me përcaktua saktë se ka qenë tani i akuzuari _____ grabitësi se kanë kaluar gati 7 vite, i kujtohet kur i ka thënë nxirre telefonin, fytyrën nuk ja ka pa. Dukshmëria natën kritike ka qenë e dobët nuk ka pasë driqim të mjaftueshëm, sytë ndoshta ja kam pa, ka qenë mashkull, kemi qenë shumë afër, më ka kapur në trup, kurse në dorë e mbante thikën, njerëz nuk ka pasur për rreth, asnjëherë nuk e kam pa personin i cili tani gjendet në sallë _____

Gjykata vazhdoj me leximin e provave në aktakuzë siç janë: Listingu i hyrjeve-daljeve nga dt. 2. 1.2012, Informacioni i PTK-së ZKL nr.623/13, ZKL nr.588/12 si dhe u bë shqimi i CD-së.

I akuzuari në mbrojtjen e tij ka deklaruar se nuk e kam parë asnjëherë të dëmtuarin thekson se shpesh i ka ndërruar aparatet telefonik, ka blerë për shokë, për familjar, i ka blerë nëpër ka blerë edhe në Mobil Shop edhe tek shitësit ambulant, ka ble për motra edhe për kushërinjtë, ka blerë telefona të llojit Iphone, Samsung, por për këtë lloj telefoni nuk më kujtohet saktë ku e ka blerë, mirëpo më doli me defekt dhe e ktheva menjëherë, sepse ska qenë funksional, baterinë se ka mbajte mirë, por më është dashtë me kthye sepse s,kam para me humb, nuk kam menduar se do ta kthej, s,kam menduar për prejardhjen e atij telefoni, i kam parë që ambulantët shitnin telefona, pa i penguar askush, andaj kam blerë edhe prej tyre, siç ka qenë telefoni Iphone.

Pas vlerësimit të dëshmisë së të dëmtuarit, administrimit të provave materiale dhe mbrojtjes së të akzuarit, gjykata e vërtetoi këtë gjendje faktike:

Dëshmia e të dëmtuarit- dëshmitarit , i cili gjatë dhënies së dëshmisë së tij ka theksuar se edhe atëherë kur e ka paraqitur rastin në polici, po edhe tani nuk është i sigurt se i akuzuari ka qenë personi që natën kritike e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Po ashtu, gjykata ka vlerësuar edhe thëniet e dëshmitarit se në momentin kur është kryer vepra penale nuk ka qenë në gjendje t'i identifikoi fytyrën e këtij personi, duke pasur parasysh se në fillim të dëshmisë së tij, i njëjti ka deklaruar se duke e pritur një shok nga mbrapa e kishte kapur për jakëne , me njërën dorë dhe me dorën tjetër ia kishte mbajtur një thikë e duke i shqiptuar fjalët " lëshoje telefonin", por as atëherë nuk e ka parë personin sepse ishte i maskuar me kapelë dhe shalle.

Edhe sa i përket Listingut të hyrjeve dhe daljeve i datës 2. 1.2012 sipas të cilit është vërtetuar se i akuzuari ishte abonent, i cili ka deklaruar se ka blerë telefonin në rrugë, por e ka kthyer menjëherë sepse ishte me defekt.

Gjykata ka vlerësuar thëniet e të dëmtuarit-dëshmitarit , kur ka theksuar " se nuk e kam parë kurrë në jetë dhe nuk është ky personi që ka qenë natën kritike i cili e ka kryer veprën penale për të cilat është akuzuar", dua ta mbylli këtë rast sa më parë, gjykata i ka marrë dhe vlerësuar në favor të akzuarit, duke u bazuar në dispozitën e nenit 3 të Kodit të Procedurës Penale të R. së Kosovës dhe mëdyshjet e cekura si më lart, e që janë interpretuar në favor të akzuarit.

Sa i përket kësaj çështje penale, trupi gjykues ka vlerësuar dhe analizuar dëshminë e të dëmtuarit - dëshmitarit dhe provat materiale të paraqitura si më lart, por me asnjërin nga këto prova nuk është arritur të vërtetohet se i akuzuari me datë me datë 30.12.2011, rreth orës 17:20 ishte kryerësi i veprës penale, në vendin dhe mënyrën siç është paraqitur në dispozitivin e aktakuzës.

Lidhur me pretendimet e Prokurorit të shtetit, se i pandehuri , ka kryer veprën penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, trupi gjykues vlerësoi se me asnjë provë nuk është vërtetuar se i pandehuri ka kryer veprat penale Grabitje, nga neni 329, par. 1, të KPK-së, andaj të njëjtin edhe e liroi nga akuza.

Ndërsa, lidhur me mëdyshjet e tani të dëmtuarit-dëshmitarit se as atëherë nuk e ka parë fytyrën e të akzuarit , por edhe në seancën e shqyrtimit gjyqësor deklaroi se kurrë në jetë se ka parë të pandehurin gjykata është bazuar në dispozitën e nenit 3 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, kur mëdyshjet si më lart i ka interpretuar në favor të akzuarit dhe të drejtave të tij, të parapara me KPPRK-së dhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Pasi që të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të përsëritshëm, në bazë të nenit 463, par. 1 dhe 2, të KPPK, pala e dëmtuar është udhëzuar në kontest juridiko-civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, u mor në bazë të nenit 454, par.1 të KPPK.

Nga sa u tha më lart, dhe në bazë të nenit 364, par.1, nënpar. 1.3, të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/ DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA PKR.nr.778/16
dt.05.06.2018

Sekretare juridike
Nuriye Rexhëbeqaj

Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari
Veseli Ismajli



UDHËZIMI JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar, brenda afatit ligjor prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimi të këtij aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit të Kosovës, me seli në Prishtinë.